



Prokurimi publik

Prokurimi i mbrojtjes

PËRMBAJTJA

- [Nocioni i prokurimit të mbrojtjes](#)
- [Karakteristika të veçanta të prokurimit të mbrojtjes](#)
- [Prokurimi i mbrojtjes në Bashkimin Evropian](#)
- [Kuari rregullator: E drejta parësore e BE-së – Rregulla dhe parime të përgjithshme](#)
- [Kuari rregullator; E drejta dytësore e BE-së – Direktiva e Mbrojtjes dhe e Sigurisë](#)
- [Çështje të tjera \(Kompensimet, regjimet paralele\)](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit të SIGMA-s.

Nocioni i prokurimit të mbrojtjes

Prokurimi i mbrojtjes është proces përmes të cilit autoritetet në fushën e mbrojtjes blejnë mallra, shërbime ose punë të ndryshme që atyre u nevojiten në mënyrë që të kryejnë detyrat e tyre. Për shembull, këto autoritete blejnë kancelari dhe pajisje të TI-së për të kryer detyrat administrative; ata blejnë ushqim për ushtarët; ata prokurojnë shërbime të pastrimit të objekteve; ata blejnë nëndetëse, avionë luftarakë, automjete të blinduara, municion, raketa dhe materiale të tjera mbrojtëse për mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe të integritetit territorial, ose për përmbushjen e angazhimeve të tjera ndërkombëtare, për shembull, pjesëmarrja në operacione paqeruajtëse jashtë vendit; ata gjithashtu prokurojnë shërbimet përkatëse të mirëmbajtjes për të ruajtur materialin mbrojtës të gatshëm për veprim në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.

Edhe pse nuk kanë asnjë përkufizim autoritar të nocionit të prokurimit të mbrojtjes, ai ndoshta do të mund të përcaktohet në mënyrë të gjerë dhe të ngushtë.

Prokurimi i mbrojtjes në një kuptim më të gjerë mbulon çdo prokurim të kryer nga autoritetet kontraktore në fushën e mbrojtjes. Këtu, nocioni i prokurimit të mbrojtjes mbulon të gjithë shembujt e përmendur më sipër: prokurimin e kancelarive, pajisjeve të TI-së, të avionëve, të nëndetëseve, etj.

Prokurimi i Mbrojtjes në kuptimin e ngushtë mbulon vetëm mallrat dhe shërbimet që *prodhohen* ose që synohet të përdoren për qëllime të pastra ushtarake, pra, duke përdorur shembujt e mësipërm, nëndetëset, avionëve luftarakë, autobindave, municioneve, raketave, dhe shërbimeve të lidhura. Mund të argumentohet se ky përkufizim i ngushtë mbulon gjithashtu prokurimin e teknologjive "me përdorim të dyfishtë", domethënë, teknologjive që mund të përdoren, në parim, si për qëllime ushtarake ashtu dhe joushtarake, me kusht që blerja të bëhet kryesisht për përdorim ushtarak dhe se specifikimet e këtyre teknologjive të "përdorimit të dyfishtë" i nënshtrohen disa ndryshimeve për të përmbushur kërkesat ushtarake.

Dallimi mes përcaktimit të ngushtë dhe të gjerë të prokurimit të mbrojtjes pasqyron faktin se disa aktivitete të prokurimit në fushën e mbrojtjes janë të lidhura shumë ngushtë me thelbin e asaj që mund të cilësohet si mbrojtja kombëtare dhe siguria kombëtare dhe karakterizohet shpesh nga natyra komplekse e teknologjive relevante (domethënë në kuptimin e ngushtë), ndërsa aktivitetet e tjera të prokurimit në të njëjtin sektor janë qartë, në parim, më pak të ndjeshme (prokurimi i pajisjeve dhe shërbimeve joushtarake). Ky dallim thekson më tej faktin se prokurimi më i ndjeshëm duhet të jetë subjekt i një regjimi rregullator që pranon specifikat e saj dhe përpiqet për të arritur një ekuilibër në mes të hapjes dhe transparencës së procesit të prokurimit, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së shqetësimeve të sigurisë thelbësore të shtetit prokurues, në anën tjetër.

Ky Udhëzim fokusohet në prokurimin e materialeve të mbrojtjes të cilat, për shkak të natyrës dhe përdorimit të tyre të parashikuar, janë të lidhura ngushtë me nocionin e mbrojtjes dhe të sigurisë. Me fjalë të tjera, ai merret me prokurimin e mbrojtjes në kuptimin e ngushtë. Përdorimi i termit "prokurimi i mbrojtjes" në pjesën tjetër të këtij Udhëzimi të prokurimit reflekton këtë përkufizim më të ngushtë.

Karakteristika të veçanta të prokurimit të mbrojtjes

Nga natyra e tij, prokurimi i mbrojtjes ka disa karakteristika dalluese.

Së pari, ai ndryshon nga prokurimi i përgjithshëm publik në terma cilësore nga fakti se ai merret me sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare.

Së dyti, shpesh pajisjet e mbrojtjes kanë tendencë të mbledhin në mënyrë teknologjike elemente komplekse të veçanta.

Si rezultat i këtij kombinimi të detyrimeve strategjike dhe të sigurisë dhe i kompleksitetit të lëndës, shumë vende të botës kanë futur legjislacion të diferencuar të prokurimit në fushën e mbrojtjes që shmanget nga standardet e përgjithshme e transparencës dhe që zakonisht kërkohen në prokurimin publik.

Shkalla e shmangies së legjislacionit të prokurimit të mbrojtjes nga standardet e përgjithshme të hapjes dhe të transparencës varion mes juridiksioneve, por gjithmonë përfshin një hapësirë më të gjerë diskrecioni se zakonisht për autoritetet kontraktore.

Për fat të keq, ky mjedis i sekretit dhe i transparencës së reduktuar, së bashku me një a disa fusha diskrecioni më të gjerë se sa ajo e zakonshme për autoritetet kontraktore, e bën atë një terren pjellor të proteksionizmit, korrupsionit dhe të shfrytëzimit joefikas të burimeve publike.

Prokurimi i mbrojtjes në Bashkimin Evropian

Prokurimi i mbrojtjes përbën një segment të dukshëm të prokurimit publik në BE. Shpenzimet totale të mbrojtjes të 28 vendeve anëtare të BE është rreth 200 miliardë euro. Kjo shifër përfshin rreth 90 miliardë euro për prokurimin në përgjithësi (domethënë blerjet, operimi dhe mirëmbajtja) dhe rreth 50 miliardë euro për blerjen e pajisjeve të reja të mbrojtjes në veçanti.

Pavarësisht nga burimet e konsiderueshme të ndara për prokurimin e mbrojtjes nga shtetet anëtare të BE-së, kontratat e prokurimit të mbrojtjes kanë qenë për disa vite subjekt i regjimeve të ndryshme të prokurimit kombëtar me rregulla dhe procedura të ndryshme të prokurimit. Këto dallime ndërmjet vendeve kanë dekurajuar dhe në disa raste edhe penguar (*de jure ose de facto*) konkurrencën ndërkufitare. Si rezultat, nuk ka pasur kurrë një treg të vërtetë pan-evropian të prokurimit të mbrojtjes, por 28 tregje kombëtare rrethuar me pengesa rregullatore për hyrjen që kanë synuar mbrojtjen e industrive të mbrojtjes kombëtare.

Copëzimi sipas linjave kombëtare i atij që mund të jetë një treg i gjerë i prokurimit të mbrojtjes së BE-së dhe politikat kombëtare proteksioniste industriale mendoheshin (gabimisht, siç shpjegohet më poshtë) se lejoheshin nga neni 346 i Traktatit për Funksimin e Bashkimit Evropian (TFBE). Në fakt, ky interpretim i gabuar i nenit 346 të TFBE-së ishte aq i përhapur sa që shpesh edhe prokurimi jo sensitiv në fushën e mbrojtjes - për shembull kancelaritë, shërbimet e pastrimit, furnizimet ushqimore – ishin përjashtuar gabimisht nga rregullat e prokurimit publik të BE-së. Është e rëndësishme të përmendet këtu se kontratat e prokurimit të pajisjeve apo shërbimeve joushtarake në fushën e mbrojtjes **janë mbuluar gjithmonë** nga Direktiva e Sektorit Publik.¹

Dalja e Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (PPSM),² e cila ka për qëllim që ta bëjë BE-në një aktor global në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, kërkon një bazë konkurruese dhe aktive të mbrojtjes evropiane industriale. Copëzimi përgjatë linjave kombëtare dhe politikat proteksioniste kombëtare, të kombinuara me kufizimet buxhetore, krijonte mungesë efikasiteti dhe dublime të burimeve që dëmtojnë konkurrencën dhe, në fund të fundit, mund të dëmtojnë besueshmërinë e PPSM-së.

Për këto arsye, Parlamenti Evropian ftoi Komisionin Evropian të bëjë propozime konkrete për reforma në fushën e industrisë së mbrojtjes, në fushën e tregjeve dhe të prokurimit. Rezultati më i prekshëm i këtij procesi është miratimi i Direktivës 2009/81/KE (Direktiva e Mbrojtjes dhe e Sigurisë) e cila ka për qëllim, ndër të tjera, që të hapë prokurimin e mbrojtjes kombëtare ndaj konkurrencës brenda Bashkimit Evropian dhe, në këtë mënyrë, të krijojë një treg të vërtetë pan-evropian të prokurimit të mbrojtjes.

¹ Direktiva 2014/24/BE për prokurimet publike dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/KE, 26 shkurt 2014.

² PPSM-ja është hartuar në vitin 1999 në formën e saj origjinale si Politika e Mbrojtjes dhe e Sigurisë Evropiane (PPSM) - ajo u riemërua si PPSE nga Traktati i Lisbonës.

Kuadri rregullator: E drejta parësore e BE-së

Rregulla dhe parime të përgjithshme

Nga pikëpamja ligjore, prokurimi i mbrojtjes është pjesë integrale e tregut të brendshëm dhe si i tillë i nënshtrohet rregullave të përgjithshme të mishëruara në Traktatet Evropiane. Në veçanti, prokurimi i mbrojtjes është subjekt i rregullave dhe parimeve themelore të mëposhtme:

- Mosdiskriminimi mbi bazën e kombësisë;
- Lëvizja e lirë e mallrave;
- Lëvizja e lirë e shërbimeve;
- Liria e vendosjes.

Përveç kësaj, ai është subjekt i parimeve të përgjithshme të së drejtës të njohura nga Gjykata e Drejtësisë së BE-së (GJED). Këto parime përfshijnë:

- Trajtimin e barabartë;
- Njohjen reciproke;
- Transparencën;
- Proporcionalitetin.

Është e rëndësishme të theksohet se këto rregulla dhe parime zbatohen për dhënien e kontratave të prokurimit edhe kur këto kontrata janë jashtë fushës së zbatimit të Direktivave të ndryshme të prokurimit (Direktiva e Sektorit Publik, Direktiva e Shërbimeve,³ dhe Direktiva e Mbrojtjes dhe e Sigurisë). Për shembull, ato zbatohen për kontratat e prokurimit vlera e të cilave është nën kufijtë përkatës monetarë të prokurimit (me përjashtim, ndoshta, të kontratave të prokurimit me vlerë shumë të vogël, që nuk tërheqin interes ndërkufitar) ose për kontratat e koncesionit të shërbimit (të cilat në rastin e sektorit publik janë të përjashtuara nga objekti i Direktivës së sektorit publik). Kjo do të thotë se këto rregulla dhe parime zbatoheshin për kontratat e prokurimit të mbrojtjes edhe para hyrjes në fuqi të Direktivës së Mbrojtjes dhe të Sigurisë.

Përjashtimi i sigurisë nga neni 346 i TFBE-së

Neni 346 i TFBE-së parashikon që Shtetet Anëtare mund të shmangen nga rregullat dhe parimet e së drejtës së BE-së dhe të miratojnë masa të jashtëzakonshme në fushën e tregtisë dhe të prodhimit të municioneve dhe materialeve të tjera të luftës, nëse këto masa janë të nevojshme për mbrojtjen e *interesave të tyre thelbësore të sigurisë*. Përveç kësaj, këto masa nuk duhet të ndikojnë negativisht në tregtinë brenda Bashkimit Evropian të produkteve që nuk lidhen me mbrojtjen.

Siç u përmend më lart, kjo dispozitë është interpretuar gabimisht nga shumica e Shteteve Anëtare duke krijuar një përjashtimin *en bloc automatik* të prokurimit të mbrojtjes nga rregullat dhe parimet e së drejtës së BE-së. Një numër çështjesh të sjella në GJED kanë treguar qartë se një interpretim i tillë i gjerë i kësaj dispozite është i paligjshëm.

Në dhjetor të vitit 2006, Komisioni Evropian ka nxjerrë një komunikim interpretues (COM (2006) 779 final, *Komunikimi interpretues mbi zbatimin e nenit 296 të Traktatit në fushën e prokurimit të mbrojtjes*), në të cilin ai shpjegoi pikëpamjet e tij në lidhje me interpretimin e duhur të nenit 346 të TFBE-së. Edhe pse ky komunikim interpretues nuk është ligjërishit i detyrueshëm, ai është i rëndësishëm sepse shpjegon mënyrën se si Komisioni do të kryejë rolin

³ Direktiva 2014/25/BE për prokurimet nga subjektet në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorëve të shërbimeve postare dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/17/KE, 26 shkurt 2014.

e tij si mbikëqyrës i së drejtës së BE-së kur përballet me masat kombëtare në fushën e prokurimit të mbrojtjes që duket se është në kundërshtim me të drejtën e BE-së.

Sipas komunikimit interpretues, Shtetet Anëtare mund të vendosin që të shmangen nga rregullat e BE-së në fushën e prokurimit të mbrojtjes në bazë *ad hoc* dhe duke iu referuar nenit 346 të TFBE-së. Me fjalë të tjera, Shtetet Anëtare nuk mund të përjashtojnë prokurimin e mbrojtjes nga fusha e zbatimit të së drejtës së BE-së në terma të përgjithshme. Përveç kësaj, kur i referohen këtij neni, Shtetet Anëtare duhet të demonstrojnë se janë plotësuar kushtet e zbatimit të kësaj dispozite. Në veçanti, shtetet anëtare duhet të tregojnë se:

- Masat kombëtare mbulojnë mallrat e mbrojtjes të përfshira në listën e hartuar në vitin 1958 nga Këshilli;
- Janë në rrezik interesa të rëndësishme thelbësore të sigurisë;
- Masat e jashtëzakonshme kombëtare janë të nevojshme për të mbrojtur interesat thelbësore të sigurisë.

Më saktësisht, pas hyrjes në fuqi të Direktivës së Mbrojtjes dhe të Sigurisë, një Shtet Anëtar duhet të demonstrojë se pse rregullat e reja "të kopsitura" të Direktiva e Mbrojtjes dhe e Sigurisë nuk mbrojnë në mënyrë të përshtatshme interesat e tij thelbësor të sigurisë.

Megjithëse kufiri i saktë i diskrecionit të Shteteve Anëtare në funksion të përcaktimit të lidhjes midis shmangies dhe mbrojtjes së një interesi thelbësor të sigurisë mbetet ende për t'u sqaruar nga GJED-ja, Komisioni Evropian së fundi ka treguar vullnetin e tij për të miratuar një qëndrim më proaktiv (shih, për shembull, hetimet kundër Greqisë dhe Republikës Çeke për mos justifikimin në mënyrë të mjaftueshme të përdorimit të nenit 346 të TFBE-së në kuadër të dy proceseve të shpalljes së fituesit të prokurimit të mbrojtjes).

Kuadri rregullator; E drejta dytësore e BE-së – Direktiva e Mbrojtjes dhe e Sigurisë

Direktiva e mbrojtjes dhe e sigurisë⁴ ka hyrë në fuqi më 21 gusht 2009. Periudha e zbatimit deri në fund ku secilit Shtet Anëtar duhet të ketë transpozuar Direktivën e mbrojtjes dhe të sigurisë në legjislacionin e tyre kombëtar ka përfunduar më 21 gusht 2011. Instrumenti i ri është pjesë e *acquis* të Bashkimit dhe, për këtë arsye, është gjithashtu i rëndësishëm për të gjithë vendet kandidatë për anëtarësim në BE dhe vendet potenciale kandidatë.

Direktiva e Mbrojtjes dhe e Sigurisë ofron një kuadër rregullator që është fleksibël dhe merr parasysh karakteristikat e veçanta të prokurimit të mbrojtjes. Qëllimi i instrumentit të ri është që të hapë tregjet kombëtarë të prokurimit të mbrojtës ndaj konkurrencës ndërkufitare duke ulur rastet e referimit të pajustificuar të nenit 346 të TFBE-së nga Shtetet Anëtare. Neni 346 i TFBE-së mbetet i pandryshuar. Megjithatë, siç u përmend më sipër, Shtetet Anëtare tani e tutje do të duhet të justifikojnë më qartë se pse është e nevojshme shmangia nga e drejta e BE-së për mbrojtjen e interesave të tyre thelbësore të sigurisë, pasi Direktiva e Mbrojtjes dhe e Sigurisë është hartuar pikërisht për t'iu përgjigjur specifikave dhe karakteristikave sensitive të prokurimit të mbrojtjes.

Fusha e aplikimit dhe kufijtë monetarë të zbatueshëm

Në parim, Direktiva e Mbrojtjes dhe e Sigurisë mbulon dy fusha të mëdha:

- Pajisjet ushtarake, kontratat e shërbimeve dhe të punëve të lidhura;
- Prokurimi sensitiv për qëllime të sigurisë (jo vetëm të mbrojtjes ose të sigurisë kombëtare) ose prokurimi që përfshin informacionin e klasifikuar.

⁴ Direktiva 2009/81/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 korrik 2009 mbi koordinimin e procedurave për dhënie dhe kontratatave të caktuara të punëve, kontratatave të furnizimit dhe kontratatave të shërbimeve nga autoritetet apo subjektet kontraktore në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, dhe për ndryshimin e Direktivave 2004/17/KE dhe 2004/18/KE.

Është e rëndësishme të theksohet se para hyrjes në fuqi të Direktivës së mbrojtjes dhe të sigurisë, prokurimi i pajisjeve ose i shërbimeve sensitive (por jo ushtarake) mbulohej në parim nga Direktivat e sektorit publik ose të shërbimeve. Kjo do të thotë se është e rëndësishme që autoritetet kontraktore të jenë të vetëdijshme për fushën e saktë të zbatimit të Direktiva e Mbrojtjes dhe e Sigurisë në lidhje me kontratat e prokurimit që mbuloheshin më parë nga Direktivat e tjera të prokurimit publik.

Arsyetimi për objektin e gjerë të Direktiva e Mbrojtjes dhe e Sigurisë është i dyfishtë: nga njëra anë, teknologjia moderne e bën dallimin në mes të teknologjisë së mbrojtjes dhe asaj civile gjithnjë e më të vështirë (shpesh, faktori përcaktues është më shumë përdorimi i një teknologjie të veçantë dhe jo natyra e asaj teknologjie). Nga ana tjetër, dallimi në mes të sigurisë së brendshme dhe sigurisë së jashtme është edhe më i vështirë. Për shembull, prokurimi i pajisjeve dhe i shërbimeve të sigurisë nga një aeroport civil në ditët e sotme ngre shqetësimet e sigurisë të krahasueshme me ato të prokurimit të mbrojtjes tradicionale. Për këtë arsye ky regjim i posaçëm fleksibël i prokurimit mbulon edhe këto kontrata të prokurimit të sigurisë.

Ashtu si me direktivat e tjera të prokurimit, vlera e kontratave përkatëse duhet të jetë mbi kufijtë monetarë të caktuar në mënyrë që të zbatohet Direktiva e mbrojtjes dhe e sigurisë. Kufijtë monetarë të zbatueshëm aktualisht janë si më poshtë:

- 418 000 Euro për kontratat e furnizimit dhe të shërbimeve;
- 5 225 000 Euro për kontratat e punëve.

Ashtu si në rastin e direktivave të tjera të prokurimit publik, këta kufij monetarë do të përditësohen në mënyrë periodike. Për informacion të mëtejshëm shih *Udhëzimin nr. 5 të prokurimit - Të kuptuarit e kufijve monetarë*.

Kontratat vlera e të cilave është nën këta kufij monetarë nuk mbulohej nga Direktiva e mbrojtjes dhe e sigurisë. Megjithatë, në qoftë se ka gjasa që ato të tërheqin interes ndërkufitar, atëherë këto kontrata mbulohej nga rregullat dhe parimet e përgjithshme të së drejtës së BE-së, për shembull, parimet e mosdiskriminimit dhe të transparencës. Për informacion të mëtejshëm mbi rregullat dhe parimet e përgjithshme që zbatohen për kontratat në kufijtë monetarë shih *Udhëzimin nr. 15 të prokurimit – Kontratat poshtë kufirit monetar*.

Procedurat e prokurimit

Ndoshta një nga rrishtë më të rëndësishme të Direktivës së Mbrojtjes dhe Sigurisë është që autoritetet kontraktore në fushën e mbrojtjes janë të lirë të zgjedhin *procedurën me negociim me njoftim paraprak* (së bashku me procedurën e kufizuar) si një procedurë standarde të prokurimit. Kjo u siguron autoriteteve kontraktore fleksibilitet më të madh dhe më shumë liri për të diskutuar me operatorët ekonomikë zgjidhjet në dispozicion. Duhet të theksohet se një qasje e ngjashme është zgjedhur për Direktivën e Shërbimeve, por jo për Direktivën e Sektorit Publik.

Përveç kësaj, autoritetet kontraktore mund të përdorin dialogun konkurrues dhe procedurën e negociuar pa njoftim paraprak për arsytet specifike. Arsytet për përdorimin e dialogut konkurrues janë të njëjta me ato që parashikohen në Direktivën e Sektorit Publik.

Arsyet për përdorimin e procedurës me negociim pa njoftim paraprak përfshijnë dy rrethana të tjera që nuk kanë asnjë ekuivalent në Direktivën e Sektorit Publik.

E para i referohet kontratave të prokurimit që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve ajrore dhe transportit detar për forcat e armatosura ose të sigurisë të dislokuara (ose që do të dislokohen) jashtë shtetit, kur autoriteti kontraktor duhet t'i prokurorë këto shërbime nga operatorët ekonomikë që garantojnë vlefshmërinë e ofertave të tyre vetëm për periudha të tilla të shkurtra që nuk mund të përmbushet afati kohor për procedurën e kufizuar ose

procedurën me negociim me njoftim paraprak (duke përfshirë edhe versionet e tyre me afatet e shkurtuara).

E dyta ka të bëjë me urgjencën që vjen si pasojë e një krize. Në raste të tilla, procedura me negociim pa njoftim paraprak mund të përdoret nëse pajtueshmëria me procedurën e kufizuar ose procedurën me negociim me njoftim paraprak (edhe në kushtet e afateve kohore të shkurtuara) nuk do të ishte në përputhje me urgjencën e krizës.

Për informacion të përgjithshëm mbi procedurat e përmendura më sipër shih *Udhëzimin nr. 10 të prokurimit - Procedurat e prokurimit publik*.

Siguria e informacionit

Një tjetër risi e rëndësishme e Direktivës së Mbrojtjes dhe të Sigurisë është përfshirja e dispozitave të veçanta të lidhura me sigurinë e informacionit. Për shkak të objektit të ndjeshëm të kontratave të prokurimit të mbrojtjes dhe të sigurisë, trajtimi i informacionit të klasifikuar është shumë i rëndësishëm. Direktiva e Mbrojtjes dhe e Sigurisë përfshin dispozita të kopsitura që përpiqen ta trajtojnë këtë çështje. Për shembull, autoriteti kontraktor mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë sa më poshtë vijon:

- Angazhimin nga ana e ofertuesit dhe e nën-kontraktorëve të identifikuar tashmë për të mbrojtur në mënyrë të përshtatshme konfidencialitetin e të gjithë informacionit të klasifikuar në zotërim të tyre ose të sjellë në vëmendjen e tyre, në përputhje me dispozitat përkatëse të shteteve anëtare për verifikimin e sigurisë;
- Angazhimin nga ana e ofertuesit për të marrë angazhimet e përshkruara më lart nga nënkontraktorët e tjerë që ai do të nënkontrakttojë gjatë realizimit të kontratës;
- Informacion të mjaftueshëm për nënkontraktorët e identifikuar tashmë për t'i mundësuar autoritetit kontraktor që të përcaktojë se secili prej tyre ka aftësitë e nevojshme për të mbrojtur në mënyrë të përshtatshme konfidencialitetin e informacionit të klasifikuar në të cilin ai ka akses ose që atyre u kërkohet që të prodhojnë gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre nënkontraktore;
- Angazhimin nga ana e ofertuesit që të japë informacionin e përshkruar më lart nga të gjithë nënkontraktorët e tjerë që ai do të nënkontrakttojë gjatë realizimit të kontratës.

Është e rëndësishme të theksohet në këtë pikë se Shtetet Anëtare duhet të njohin lejet e barasvlershme të sigurimit të lëshuara nga shtetet e tjera anëtare. Vendimi në lidhje me ekzistencën e ekuivalencës së tillë i përket Shtetit Anëtar prokurues.

Siguria e furnizimit

Siguria e furnizimit në kontekstin e prokurimit të mbrojtjes dhe të sigurisë është i një rëndësie themelore. Shtetet Anëtare shpesh janë përpjekur për të justifikuar largimin nga rregullat e prokurimit të BE-së duke u mbështetur pikërisht mbi këtë bazë. Në fakt, mungesa e dispozitave të veçanta për sigurinë e furnizimit ka qenë një nga arsyet se përse Direktiva e Sektorit Publik është konsideruar e papërshtatshme për kontratat e prokurimit të mbrojtjes.

Direktiva e Mbrojtjes dhe e Sigurisë përfshin dispozita të veçanta që përpiqen për t'i'u përgjigjur shqetësimeve të Shteteve Anëtare. Në veçanti, Direktiva e Mbrojtjes dhe e Sigurisë siguron që autoritetet kontraktore duhet të specifikojnë të gjitha kërkesat e sigurisë së furnizimit në dokumentet e kontratës dhe mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë sa më poshtë vijon:

- Certifikim ose dokumentacion që demonstroi (sipas kërkesave të autoritetit kontraktor) që ofertuesi do të jetë në gjendje për të përmbushur detyrimet e tij në lidhje me eksportin, transferimin dhe transitin e mallrave që lidhen me kontratën;
- Tregues të çdo kufizimi ndaj autoritetit kontraktor në lidhje zbulimin, transferimin ose përdorimin e produkteve dhe shërbimeve ose të rezultateve të këtyre produkteve apo shërbimeve, që do të dalin nga kontrolli i eksportit ose masat e sigurisë;
- Certifikim ose dokumentacion që tregon se organizimi dhe vendndodhja e zinxhirit të furnizimit të operatorit ekonomik do të bëjë të mundur që ai të jetë në përputhje me kërkesat e autoritetit/subjektit kontraktor në lidhje me sigurinë e furnizimit, dhe angazhimin për të siguruar që ndryshimet e mundshme në zinxhirin e furnizimit gjatë zbatimit të kontratës nuk do të ndikojnë negativisht në respektimin e këtyre kërkesave;
- Angazhimin e ofertuesit për të krijuar dhe/ose ruajtur kapacitetin e kërkuar për të përmbushur nevojat shtesë të autoritetit kontraktor si rezultat i një krize dhe çdo dokumentacioni mbështetës të marrë nga autoritetet kombëtare të ofertuesit në lidhje me plotësimin e nevojave të tjera të autoritetit/entitetit kontraktor si rezultat i një krize;
- Angazhimin e ofertuesit për të kryer mirëmbajtjen, modernizimin apo adaptimin e furnizimeve të mbuluara nga kontrata;
- Angazhimin e ofertuesit për të informuar autoritetin kontraktor në kohën e duhur për çdo ndryshim të organizatës, zinxhirit të furnizimit apo të strategjisë industriale që mund të ndikojë në detyrimet e tij ndaj atij autoriteti;
- Angazhimin e ofertuesit për t'i siguruar autoritetit kontraktor/njësisë ekonomike, në bazë të termave dhe kushteve të rëna dakord, të gjitha mjetet e nevojshme të specifikuar për prodhimin e pjesëve të këmbimit, të komponentëve përbërës, të montimeve dhe të pajisjeve të veçanta të testimit, duke përfshirë vizatimet teknike, licencat dhe udhëzimet e përdorimit, në rast se ai nuk është më në gjendje t'i ofrojë këto furnizime.

Vlen të përmendet se autoritetet kontraktore nuk mund të detyrojnë një ofertues që të marrë një angazhim nga një Shtet Anëtar që ky i fundit nuk do të zbatojë kriteret e tij kombëtare të eksportit, transferimit ose të transimit, me kusht që këto të jenë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare apo të Bashkimit Evropian.

Mjetet juridike

Një tjetër tipar i rëndësishëm i Direktivës së Mbrojtjes dhe të Sigurisë është se, përveç dispozitave materiale, ajo gjithashtu përfshin masa të veçanta mbi mjetet juridike. Dispozitat mbi mjetet juridike janë në përputhje me ato të Direktivës së Mjeteve Juridike (Direktiva 89/665/KE e ndryshuar nga Direktiva 2007/66/KE). Për informacion mbi kërkesat e Direktivës së Mjeteve Juridike shih *Udhëzimin e Prokurimit nr. 12 – Mjetet juridike*.

Ka disa variacione që korrespondojnë me specifikat e prokurimit të mbrojtjes dhe të sigurisë. Për shembull, pavlefshmëria e kontratës nuk mund të mos ekzistojë nëse pasojat e kësaj pavlefshmërie do të rrezikonin një kontratë më të gjerë të mbrojtjes ose të sigurisë.

Në përputhje me natyrën specifike të prokurimit të mbrojtjes dhe të sigurisë, Shtetet Anëtare janë të lira për të krijuar një organ të veçantë që ka juridiksion vetëm për shqyrtimin e rasteve të prokurimit të mbrojtjes dhe të sigurisë, me kusht që ai të mbrojë të gjitha garancitë e procesit të rregullt në shqyrtimin gjyqësor dhe se vendimi përkatës i prokurimit shqyrtohet në

fund të fundit nga një organ që konsiderohet si gjykatë për qëllimet e së drejtës së BE-së (domethënë një organ që mund t'i referojë çështjet paraprake tek GJED-ja).

Çështje të tjera

Kompensimet

Kompensimet janë praktika të ndjekura nga autoritetet kontraktore në fushën e prokurimit të mbrojtjes me qëllim të granatimit të një lloj kthimi të "investimeve" të tyre për industrinë e tyre të brendshme, domethënë pagesa e dhënë një kontraktori të huaj të mbrojtjes për blerjen e pajisjeve të mbrojtjes ose shërbimet e lidhura. Për shembull, kompensimi mund të marrë formën e pjesëmarrjes në industrinë e mbrojtjes së shtetit prokurues në fazën e hartimit të një kontrate të mbrojtjes me anë të *bashkë-prodhimit* ose përmes *nënkontraktimit*, apo të përfshirjes së industrisë vendase si një nënkontraktor në kontratat e ardhshme të furnitorit të huaj. Kompensimet mund të paraqiten si kusht për pjesëmarrjen e kontraktorëve të huaj në një proces të veçantë të prokurimit ose si kriter për shpalljen e fituesit. Kompensimet përbëjnë një tipar të përbashkët të regjimeve të prokurimit të mbrojtjes së vendeve me baza të vogla ose të mesme industriale të mbrojtjes.

Direktiva e Mbrojtjes dhe e Sigurisë nuk merret në mënyrë eksplicite me çështjen e rëndësishme të kompensimeve. Megjithatë, qëndrimi i Komisionit Evropian i shprehur në Komunikatën Interpretuese për nenin 296 KE (tani Neni 346 i TFBE-së) dhe në Shënimin Udhëzues për kompensimet është se kompensimet janë, nga natyra e tyre, diskriminuese, pasi ato kanë për qëllim që të promovojnë industrinë vendase të shtetit prokurues. Kjo do të thotë se, në parim, kompensimet janë në kundërshtim me të drejtën e BE-së.

Megjithatë, praktikat specifike të kompensimit mund të arsyetohen në bazë të një prej përjashtimeve që ekzistojnë në Traktatet e BE-së. Më i rëndësishmi është padyshim Neni 346 i TFBE-së. Me fjalë të tjera, Shtetet Anëtare mund të justifikojë kompensime të caktuara nëse këto praktika përbushin kushtet e nenit 346 të TFBE-së siç u diskutua më sipër. Është e rëndësishme të theksohet në këtë pikë se Komisioni Evropian konstaton se do të jetë shumë e vështirë për të justifikuar të ashtuquajturat kompensime joushtarake, domethënë, detyrimet e kompensimit të vendosura mbi një kontraktor të huaj që nuk janë të lidhura me sektorin e mbrojtjes. Për shembull, nëse një kontraktor i mbrojtjes i huaj detyrohet të blejë një numër të caktuar fotokopjuesish nga industria e shtetit prokurues - në bazë të nenit 346 të TFBE-së, sepse ata nuk kanë një lidhje të qartë me shqetësimet themelore të sigurisë të Shtetit Anëtar prokurues.

Një nismë e kohëve të fundit e Agjencisë së Mbrojtjes Evropiane (AME), Kodi i Sjelljes për Kompensimet (që ka hyrë në fuqi më 1 korrik 2009), përpiket që të minimizojë efektet negative të kompensimeve.

Siç u përmend më lart, Direktiva e Mbrojtjes dhe e Sigurisë nuk përfshin dispozita për kompensimet. Megjithatë, ajo përfshin një sërë dispozitash për "nënkontraktimin" që ka për qëllim që të trajtojë disa nga shqetësimet që kanë çuar në miratimin e kompensimeve nga Shtetet Anëtare, për shembull mbrojtja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), por në një mënyrë që është në përputhje me të drejtën e BE-së. Në veçanti, Direktiva e Mbrojtjes dhe e Sigurisë i lejon Shtetet Anëtare që të kërkojnë që kontraktori kryesor të nënkontrakttojë pjesë të kontratës tek palët e treta. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se nënkontraktori potencial nuk mund të diskriminohet në bazë të kombësisë. Ky është dallimi i madh në mes të dispozitave "nënkontraktore" të Direktivës së Mbrojtjes dhe të Sigurisë dhe praktikave të kompensimit.

Regjimet paralele:

- **Kodi i sjelljes i AME-së për prokurimin e mbrojtjes**

Një tjetër regjim i rëndësishëm në fushën e prokurimit të Mbrojtjes të BE-së është Kodi i Sjelljes për Prokurimin Mbrojtjes i Agjencisë Evropiane të Mbrojtjes (duke nisur nga 1 korriku 2006).

Ky është një regjim vullnetar jo ligjërishit detyrues dhe jo ligjërishit i zbatueshëm në rastet e kontratave të prokurimit, kur përbushen kushtet e nenit 346 të TFBE-së, me fjalë të tjera, në rastet që nuk mbulohen nga Direktiva e Mbrojtjes dhe e Sigurisë.

Kodi i Sjelljes zbatohet për kontratat e prokurimit të mbrojtjes - por jo të sigurisë - vlera e të cilave tejkalon 1 milion euro. Kontratat që i nënshtrohen këtij regjimi duhet të përbushin kërkesat e publikimit që janë shumë më të thjeshta se sa ato të përcaktuara nga Direktiva e Mbrojtjes dhe e Sigurisë. Në veçanti, autoritetet kontraktore janë të lira të zgjedhin çdo procedurë të prokurimit, me kusht që ato të jenë në përputhje me parimet e transparencës, mosdiskriminimit dhe të trajtimit të barabartë. Me fjalë të tjera, regjimi ka të njëjtat qëllime si Direktiva e Mbrojtjes dhe e Sigurisë, por ajo mbulon një fushë në dukje të ndryshme (domethënë kontratat e prokurimit, kur përbushen kushtet e nenit 346 të TFBE-së) dhe është shumë më pak urdhërues. Mundësitë e kontratës publikohen në një portal elektronik qendror që mund të përdoret nga të gjithë.

Rëndësia e Kodit të Sjelljes duhet të zvogëlohet pas hyrjes në fuqi të Direktivës së Mbrojtjes dhe të Sigurisë, meqenëse qëllimi është që Shtetet Anëtare do të përdorin më pak nenin 346 të TFBE-së, duke pasur parasysh natyrën e kopsitur të Direktivës së Mbrojtjes dhe të Sigurisë.

- **Prokurimi i mbrojtjes: BE-vendet e treta**

Siç u përmend më lart, Direktiva e Mbrojtjes dhe e Sigurisë tani është pjesë e *acquis* së BE-së, që do të thotë se të gjithë kandidatët e tanishëm apo të ardhshëm të zgjerimit të BE-së do të duhet ta fusin atë në legjislacionin e tyre kombëtar.

Në lidhje me angazhimet ekzistuese të ndërmarrë nga BE-ja dhe shtetet e tij anëtare në drejtim të vendeve të treta sipas Marrëveshjes së Prokurimit Qeveritar shumëpalëshe (MPQ), mund të thuhet se Neni XXIII (1) i MPQ-së lejon çdo palë nënshkruese që të ndërmarrë "... çdo veprim ... të cilin ajo e konsideron të nevojshëm për mbrojtjen e interesave të sigurisë në lidhje me prokurimin e armëve, municioneve ose të materialeve luftës, ose për prokurimin e domosdoshëm për sigurinë kombëtare, ose për qëllime të mbrojtjes kombëtare." Gjithashtu, Pjesa (3) e Aneksit I të Marrëveshjes së Prokurimit Qeveritar tregon qartë se palët nënshkruese të përjashtuara nga prokurimi i pajisjeve të mbrojtjes nga fusha e zbatimit të Marrëveshjes së Prokurimit Qeveritar. Kjo është përmendur gjithashtu në mënyrë të qartë në Preambulën e Direktivës së Mbrojtjes dhe të Sigurisë në nenin 18.

Duhet të theksohet në këtë pikë se objekti i nenit XXIII (1) të Marrëveshjes së Prokurimit Qeveritar është më i gjerë se objekti i nenit 346 të TFBE-së pasi ai i referohet jo vetëm "armëve, municionit ose materialeve të luftës", por edhe "prokurimit të domosdoshëm për sigurinë kombëtare". Kjo do të thotë se Shtetet Anëtare mund t'i referohen nenit XXIII (1) të Marrëveshjes së Prokurimit Qeveritar edhe në rastet e prokurimeve të ndjeshme të pajisjeve jo ushtarake.

Informacion i mëtejshëm

Botime

Faqja e internetit e Komisionit Evropian për Prokurimin Mbrojtjes, e cila përmban komunikimet interpretuese dhe shënime udhëzuese, duke përfshirë ato të përmendura në këtë Udhëzim të Prokurimit:

http://ec.europa.eu/internal_market/publicprocurement/rules/defence_procurement/

Burime të tjera

Faqja e internetit e Agjencisë Evropiane të Mbrojtjes për Kodin e Sjelljes të përmendur në këtë Udhëzim të prokurimit: <http://www.eda.europa.eu>